

UDHËZUES PËR PËRGATITJEN E ABSTRAKTIT

Abstraktet do të pranohen në mënyrë elektronike në adresën dentalcongress2015@shdsh.org.

Afati përfundimtar për dorëzimin e abstraktit është data 15 Shtator 2015, ora 24.00.

Ju lejohet të paraqitni vetëm një abstrakt por mund të jeni bashkautor në një tjerë.

Pranimi i abstraktit përmban detyrimin e regjistrimit dhe prezantimit të tij në konferencë.

Në të kundërt punimi juaj do të konsiderohet jo i pranuar në konferencë dhe nuk do të pajiseni me certifikatën përkatëse.

Kërkesa të përgjithshme

Abstrakti duhet të raportojë një formë kërkimi shkencor në fushën dentare, stomatologjike. Ai duhet të përmbajë të dhëna dhe të ndjekë principet e një kërkimi shkencorë.

Abstrakti duhet të shkruhet me shkrim *Times New Roman*, madhësia e gjithë tekstit 10.

Titulli

Titulli duhet të jetë **Bold** dhe të përmbajë jo më shumë se 12 fjalë.

Emrat e autorëve (maksimumi 5) duhet të shkruhen me shkronja *KAPITALE ITALIC* dhe emri i autorit që prezanton duhet të ketë një asterisk (*). Institucioni i autorit të parë duhet të shkruhet në *italics*. Vetëm institucioni i autorit të parë duhet të shkruhet.

Titulli duhet të reflektojë subjektin e kërkimit shkencor.

Teksti

Teksti duhet të jetë i ndarë dhe të pasqyrojë : *Qëllimin , Metodën, Rezultatet, Konkluzionet.*

Qëllimi): duhet të jetë shprehur qartë.

Metoda : duhet të përmbajë ku, kur dhe në cilin grup janë grumbulluar të dhënat dhe të japin detaje mbi përzgjedhjen e mostrës dhe pse mostra mund të konsiderohet ose jo përfaqësuese e popullatës në studim.

Në rastet kur studimi përmban grupe kontrolli dhe teste statistikore , ato duhet të përmenden.

Rezultatet: duhet të pasqyrojnë gjetjet më të rëndësishme.

Konkluzionet: duhet të theksojnë gjetjet më të rëndësishme dhe të bazohen në rezultatet e studimit.

Mirënjohje: Nëse keni financime apo ndihmë nga individë apo subjekte të tjera për të cilat dëshironi të shprehni mirënjohjen duhet të shkruani nën këtë titull.

Abstrakti nuk duhet të jetë më i gjatë se 26 rreshta (maksimumi 350 fjalë) dhe duhet të shkruhet në një paragraf.

Përzgjedhja e abstrakteve për prezantim në konferencë

Abstraktet do të rishikohen nga një komision për respektimin e kriterëve të paraqitjes së abstraktit dhe kërkesave studimore paraqitur më poshtë. Nëse do të kërkohen korrekte apo sqarime do të kontaktoheni me email nga një anëtar i komisionit.

Në rastet kur nuk respektohen kërkesat për korrektim, sqarim apo afatet e përcaktuara në emailin që do të merret nga anëtari i komisionit, abstrakti do të refuzohet.

Konfirmimi për pranimin apo refuzimin e abstraktit do të dërgohet me email në autorin që do të prezantojë punimin.

Me rëndësi:

Ju lutemi sigurohuni që të përfshini bashkë me abstraktin edhe adresën e emailit të prezantuesit të punimit shkencor dhe të jeni në gjendje të përgjigjeni menjëherë ndonjë email nga ana e komisionit shkencor.

Mos respektimi i afateve, kriterëve të përgatitjes së abstrakteve dhe dokumenteve të tjera që kërkohen sjell automatikisht refuzimin e pranimit të punimit shkencor.